




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 21.05.2019

PROPOZIM PËR AMENDAMENTE

PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR TRAJTIMIN FINANCIAR, SUPLEMENTAR, TË PUNONJËSVE QË KANË
PUNUAR NË MINIERA, NË NËNTOKË, TË PUNONJËSVE
TË INDUSTRIËS SË NAFTËS E TË GAZIT DHE TË PUNONJËSVE QË KANË
PUNUAR NË METALURGJI”**

**Drejtuar: Zotit GRAMOZ RUÇI
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

I nderuar Z. Kryetar,

Bazuar në nenin 75, pika 4, të Rregullores së Kuvendit i paraqesim seancës plenare amendamentet e mëposhtëme:

Në projektligjin e sipër cituar propozoj riformulimet dhe shtesat si vijon:

1. Neni 2, gërma ç):

Pas shprehjes “në industrinë e naftës e të gazit”, ndryshohet: “personeli inxhiniero-teknik dhe kërkimor-shkencor”, me këtë ndrushim pika ç), riformulohet:

“Punonjësit, të cilët kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit, personeli inxhiniero-teknik dhe kërkimor-shkencor që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmikë, gjeofizikë kantieriale, përpunim dhe transport me naftësjellës dhe gazsjellës”.

2. Neni 3, gërma c); riformolohet si vijon:


“Periudhat e punës të kryera në industrinë e naftës e të gazit nga personeli inxhiniero-teknik dhe kërkimor-shkencor që ka punuar drejtpërdrejt në prodhim në ndërmarrjet e sistemit të naftës, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmikë, gjeofizikë kantieriale, përpunim dhe transport me naftësjellës dhe gazsjellës”.

3. Neni 5, gërma c):

Në paragrafin e gërmës c), shprehja “dhe personeli inxhiniero-teknik”, të zvendësohet me shprehjen “personeli inxhiniero-teknik dhe kërkimor-shkencor”.

DEPUTETI PROPOZUES

ISMET BEQIRAJ

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Ismet Beqiraj', with a stylized flourish at the end.